



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 27.7.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Agim Aliu, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević

Munguan: Doruntinë Maloku, Donika Kadaj-Bujupi dhe Fatmir Limaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Kaltrina Ahmeti dhe Tringa Bytyqi – GLPS, Erbleina Morina dhe Fitore Berisha -ZPRK, Alma Tafarshiku – EULEX, Dibrani Istrefi – Klan Kosova, Dukagjin Maliqi – RTV Dukagjini, Pranvera Musa Kosova Press, Blerta Bejtullahu-EUSR/EU Office, Petrit Hysaj – OSBE, Hamit Mjeku dhe Zahir Çerkini- praktikantë në Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 25 dhe 26.5.2015;
3. Shqyrtimi i propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për kërkesa pronësore;
4. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Këshillit në Agjencinë për Ndihmë Juridike falas;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-15 për Letërnjoftim;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-23 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri;

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-25 për shëndetin mendor;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja, propozoi që në piken të ndryshme të procedohet shkresa e përgatitur nga Nën-komisioni për mandate, imunitete dhe rregulloren e Kuvendit lidhur me heqjen e imunitetit të z. Enver Hasanit dhe znj. Arta Rama Hajrizi.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 25 dhe 26.5.2015;

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 25 dhe 26.5.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin për kërkesa pronësore;

Kryetarja, tha se për këtë pozitë Gjykata Supreme ka propozuar z. Avdullah Aliun, ligjërues në Fakultetin Juridik të UP “Hasan Prishtina” dhe znj. Drita Rexha, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ajo tha se meqë z. Avdullah Aliu tashmë është zgjedhur edhe pyetës në Komisionin për dhënien e provimit të jurisprudencës, do të ishte më e drejtë të jetë znj. Drita Rexha.

Armend Zemaj, tha se për shkak të natyrës së punës që ka Komisioni për kërkesa pronësore vlerësoj që më kompetent është z. Avdullah Aliu.

Meqë nuk kishte diskutime tjera, Komisioni me shumicë votash vendosi që Kuvendit të Republikës së Kosovës t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të emërohet Avdulla Aliu, anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore.

4. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Këshillit në Agjencinë për Ndihmë Juridike falas;

Kryetarja, tha se kemi marrë propozimet nga institucionet e përcaktuara me ligj siç janë: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Oda e Avokatëve të Kosovës, Gjykata Supreme, Organizata Joqeveritare (OJQ) dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim. Ajo paraqiti vërejtje në propozimet nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, pasi që shkresa nga kjo ministri nuk ka ardhur në formatin e zakonshëm, pasi që logoja e kësaj ministrie është shkruar me

shkronja cirilike dhe për këtë është e nevojshme ta kemi një sqarim nga administrata e Kuvendit. Ftoj anëtarët që nëse kanë propozime për anëtar nga institucionet tjera të vazhdojmë kurse me propozimet nga Ministria për Komunitete dhe kthim ta lëmë për mbledhjen e ardhshme.

Nezir Çoçaj propozoi që nga Ministria e Drejtësisë të jetë Ardian Bajraktari.

Agim Ademaj propozoi Baki Gimollin.

Kryetarja hodhi në votim propozimet ku me 4 vota “për” dhe 3 “kundër” Komisioni përkrahu propozimin e deputetit Nezir Çoçaj.

Selviqe Halimi propozoi që nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të jetë Feim Osmani. I njëjti u përkrah nga Komisioni.

Armend Zemaj propozoi që nga Ministria e Financave, të jetë Enis Spahiu. I njëjti u përkrah nga Komisioni.

Agim Aliu propozoi që nga Oda e Avokatëve të Kosovës të jetë Safet Voca. I njëjti u përkrah nga Komisioni.

Armend Zemaj propozoi që nga Gjykata Supreme, të jetë Valon Totaj. I njëjti u përkrah nga Komisioni.

Agim Aliu propozoi që nga Organizata Joqeveritare (OJQ), të jetë Adem Lushaj, kurse Albulena Haxhiu propozoi Halit Gashin. Komisioni me shumicë votash e përkrahu propozimin e deputetit Agim Aliu.

Albulena Haxhiu, nuk mori pjesë në votimin e propozimeve për anëtar të Këshillit për Ndihmë Juridike falas.

Pas diskutimeve, Komisioni me shumicë votash vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike falas, kandidatët:

1. Ardian Bajraktari, Ministria e Drejtësisë;
2. Feim Osmani, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
3. Enis Spahiu, Ministria e Financave;
4. Safet Voca, Oda e Avokatëve të Kosovës;
5. Valon Totaj, Gjykata Supreme, dhe
6. Adem Lushaj, Organizata Joqeveritare (OJQ).

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-15 për Letërnjoftim;

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-15 për Letërnjoftim dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërtetje.

Meqë nuk kishte vërejtje, Kryetarja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-15 për Letërnjoftim dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t’i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-23 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri;

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-23 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërtetje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-23 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t’i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-25 për shëndetin mendor;

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-23 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërtetje.

Meqë nuk kishte vërejtje, Kryetarja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Të ndryshme.

Shkresa e Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit,. lidhur me heqjen e imunitetit të z. Enver Hasanit dhe znj. Arta Rama Hajrizi.

Kryetarja tha se Nënkomisioni, duke u bazuar kërkesën e Gjykatës Themelore të Prishtinës, ka përgatitur përgjigjen të cilën e keni para vetes. Siç shihet në këtë draft thuhet”

- Nuk bie në fushëveprim të komisionit çështja e heqjes së imunitetit për zyrtarët e lartë.
- Në kompetencë të komisionit bie vetëm shqyrtimi i kërkesave për heqjen e imunitetit dhe mandatit të deputetëve.
- Mandati për z. Enver Hasani ka përfunduar dhe i njëjti tani nuk e ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.
- Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, në rastin nr. KO98/11 ka sqaruar çështjen e imunitetit.”

Më tej tha se unë kam propozuar që pika ku thuhet “Nuk bie në fushëveprim të komisionit çështja e heqjes së imunitetit për zyrtarët e lartë”, të hiqet për faktin se nëse ne i japim interpretim kësaj çështje duke thënë se z. Enver Hasani dhe znj. Arta Rama Hajrizi, nuk kanë imunitet, nuk ka logjikë që të themi se nuk bie në fushëveprimin e Komisionit.

Po ashtu propozoi që shkresës së Nënkomisionit ti shtohen edhe fjalët: “ Pretendimet e juaja për veprat e supozuara dhe të kryera si falsifikim i dokumentit nuk hyn në fushëveprimtarinë funksionale dhe profesionale të Gjykatës Kushtetuese. Kjo e detyron prokurorin dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë, që bazuar në ligjet në fuqi të fillojë procedurën e ndjekjes pa kërkuar çfarëdo heqje të imunitetit për çdo zyrtarë të lartë”. Nëse bëhet këto ndryshime në shkresë vlerësoj se do të jetë më e qartë për Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Armend Zemaj tha se ne e kemi shqyrtuar dhe e kemi përgatit këtë draft dhe nuk pajtohem që të hiqet pika e parë, pasi që ne nuk e heqim imunitetin e zyrtarëve të lartë por i shqyrtojmë vetëm

kërkesat për heqjen e imunitetit dhe mandatin e deputetëve. Pajtohem që të përfshihet pjesa ku thuhet “Pretendimet e juaja për veprat e supozuara si falsifikim i dokumentit nuk hyn në fushëveprimtarinë funksionale dhe profesionale të Gjykatës Kushtetuese.” Kurse pjesa tjetër nuk ka nevojë të thuhet sepse nënkuptohet që prokuroria dhe gjykatat veprojnë sipas ligjeve në fuqi.

Selvije Halimi tha se kërkesa e gjykatës nuk është kompetencë e këtij komisioni dhe vlerësoi se duhet të mbetet versioni i Nënkomisionit i pa ndryshuar, si përgjigje për Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Kishte mospajtime nga ana e anëtarëve të Komisionit z. Armend Zemaj dhe Selvije Halimi, lidhur me propozimin e kryetares së Komisionit, që të përfshihen edhe fjalët “Pretendimet e juaja për veprat e supozuara dhe të kryera si falsifikim i dokumentit nuk hyn në fushëveprimtarinë funksionale dhe profesionale të Gjykatës Kushtetuese. Kjo e detyron prokurorin dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë, që bazuar në ligjet në fuqi të fillojë procedurën e ndjekjes, pa kërkuar çfarëdo heqje të imunitetit për çdo zyrtarë të lartë”.

Kryetarja e komisionit adresoi kritika lidhur me sistemin e drejtësisë dhe ndërhyrjet politike që po i bëhen nga politikanet e PDK-së.

Lidhur me këtë deputetja Selvije Halimi tha se në njërin anë ju po kërkon një sistem të pavarur të drejtësisë e në anën tjetër ju si kryetare e Komisionit po interferoni në çështjet që nuk janë kompetencën e këtij komisioni. Kjo shihet edhe në propozimin e juaj, ku thuhet “ për veprat e supozuara dhe të kryera si falsifikim i dokumentit”. Një fjalë thuhet “të supozuara” dhe tjetra “të kryera”, e që janë në kundërshtim me njëra tjetrën.

Pas debatit, për këtë çështje deputetët Selvije Halimi dhe Nezir Çoçaj u larguan nga mbledhja.

Agim Aliu tha se shpesh si komision po vijmë në situata të konfliktit dhe ia tërhoqi vërejtjen kryetares së Komisionit se nuk është mirë të bëhen kualifikime as nga ju dhe as nga asnjëri deputet, sepse kështu po shkelet një e drejtë fundamentale siç është prezumimi i pafajësisë.

Në fund propozoi që përgjigja për Gjykatën Themelore të shtyhet për një takim të radhës, në mënyrë që të kemi një draft final të harmonizuar edhe të Nënkomisionit.

Deri sa kryetarja e Komisioni e hodhi në votim propozimin që Gjykatës Themelore në Prishtinë ti adresohet përgjigja e Nënkomisionit pa ndryshime, Agim Aliu u largua nga mbledhja dhe Komisioni nuk kishte kuorum për të vazhduar me votim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:55.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu